



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS

DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 230 Prot.

Patos më, 21 / 01 / 2025

Miratohet  
Kryetari  
Fation Duro

PROJEKT-VENDIM

Nr. 04, datë 21 . 01 . 2025

**PËR MIRATIMIN E ZBATIMIT TË PROJEKTIT TË RIKONSTRUKSIONIT TË  
RRUGËS LIDHËSE FRASHËR-FSHAT I RI, ZHARRËZ**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, kërkesave të vazhdueshme të banorëve në dëgjuesat publike të zhvilluara në Njësinë Administrative Zharrëz përgjatë vitit 2024, kërkesës me nr. 3981 prot., datë 31/10/2024 për financimin e projektit me objekt “Rikonstruksioni i rrugës lidhëse Frashër-Fshat i Ri Zharrëz”, shkresës nr. 3981/1 prot., datë 09/01/2025 në të cilën është konfirmuar miratimi i financimit të projektit të aplikuar nga ana e kompanisë Bankers Petroleum Albania L.t.d.

Ekipi i programit të menaxhimit në kuadër të finalizimit me sukses të këtij aplikimi për të vazhduar me procedurat e mëtejshme të implementimit të projektit i kërkon këshillit të bashkisë:

1. Miratimin e zbatimit të projektit “Rikonstruksioni i rrugës lidhëse Frashër-Fshat i Ri Zharrëz” me vlerë 11,999,245.06 (njëmbëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e dyzetë e pesë pikë zero gjashtë) lekë me tvsh të financuar nga Bankers Petroleum.
2. Miratimin e vlerës prej 204,591.05 (dyqind e katër mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e një pikë zero pesë) lekë (ku përfshin vlerën mbikqyrje dhe kolaudim të projektit) të cilat do të mbulohen nga buxheti vendor me transfertë nga fondet e trashëguara.

**EKIPI I PROGRAMIT TË MENAXHIMIT TË RRJETIT RRUGOR RURAL**

**DREJTUES I PROGRAMIT**

Ermenita MICI

**Anëtarët e Programit**

Silvana MICI

Arlind RUSTO

Boreta MURATI

Gazmira PLESATI

**JURISTE**

Nurkë HAZIZAJ



REPUBLIKA E SHqipërisë  
BASHKIA E PATOS

Nr. 230 / Prot.  
1

Patos më, 21 / 01 / 2025

**RELACION PËR PROJEKT-VENDIM**

***PËR MIRATIMIN E ZBATIMIT TË PROJEKTIT TË RIKONSTRUKSIONIT TË  
RRUGËS LIDHËSE FRASHËR-FSHAT I RI, ZHARRËZ***

Pas kërkesave të vazhdueshme të banorëve të Njesisë Administrative Zharrëz, të cilët kanë shprehur shqetësimin për gjendjen e amortizuar dhe nevojën për ndërhyrje në rehabilitimin e rrugës, e cila lidh fshatin Frashër me Fshatin e Ri Zharrëz, Bashkia Patos ka hartuar projektin e rikonstruksionit të këtij segmenti rrugor.

Gjendja aktuale e rrugës është në kushte jo të mira për shkak të mungesës së ndërhyrjeve prej vitesh, me përjashtim të disa ndërhyrjeve me shtresë çakëlli, duke u bërë problematike për banorët e zonës dhe një kërkesë e domosdoshme për ndërhyrje në rehabilitimin e saj.

Rruga e cila do të nënshtrohet rikonstruksionit i shërben jo vetëm banorëve por dhe fermerëve në lidhje me aktivitetet tregtare të zonës pasi siguron aksesin mes fshatit “Frashër” dhe “Fshatit të Ri, Zharrëz”. Pjesë e kësaj rruge janë dy segmente të emërtuara “Fitorja” dhe “Lushnjari”. Në total gjatësia e rrugës që kërkohet të rehabilitohen është 1150 m ose 1.15km.

Referuar situatës së mësipërme ndërhyrja për rikonstruksionin e kësaj rrugës shikohet si një domosdoshmëri për krijimin e një infrastrukture të qëndrueshme për të gjithë zonën. Bashkia Patos ka hartuar projektin e rikonstruksionit të kësaj rruge, ku përfshihet rehabilitimi i karrexhatës së rrugës me paketën e shtresave të nevojshme. Vlera e projektit është 11,999,245.04 lekë me tvsh e cila do të financohet nga kompania Bankers Petroleum të cilët kanë shprehur miratimin e financimit të investimit me anë të shkresës nr. 3988/1 prot., datë 09/01/2025. Vlera prej 204,591.05 lekë me tvsh (që përfshin mbikqyrje dhe kolaudim) do të likujdohet nga bashkia Patos me anë të fondeve të trashëguara.

**Nisur nga sa më sipër, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:**

1. Miratimin e zbatimit të projektit “Rikonstruksioni i rrugës lidhëse Frashër-Fshat i Ri Zharrëz” me vlerë 11,999,245.06 (njëmbëdhjetë milion e nëntëqind e

nëntëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e dyzetë e pesë pikë zero gjashtë) lekë me tvsh të financuar nga Bankers Petroleum.

2. Miratimin e vlerës prej 204,591.05 (dyqind e katër mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e një pikë zero pesë) lekë (ku përfshin vlerën mbikqyrje dhe kolaudim të projektit) të cilat do të mbulohen nga buxheti vendor me transfertë nga fondet e trashëguara.
3. Për ndjekjen e zbatimin e projektvendimit ngarkohet drejtoria e projekteve dhe emergjencave civile, drejtoria e financës, sektori i prokurimeve dhe drejtoria e planifikimit dhe monitorimit të shërbimeve.

#### **EKIPI I PROGRAMIT TË MENAXHIMIT TË RRJETIT RRUGOR RURAL**

##### **DREJTUES I PROGRAMIT**

Ermenita **MICI**

##### **ANËTARËT E PROGRAMIT**

Silvana **MICI**

Arlind **RUSTO**

Boreta **MURATI**

Gazmira **PLESATI**

**KRYETARI**

Faton Duro







REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA PATOS  
DREKTORIA E PROJEKTEVE DHE  
EMERJENCAVE CIVILE

EMERTIMI I PROJEKTEVE  
RIKONSTRUKSIONI I  
RRUGES LIDHJESE  
FRASHER-PESHAT I RI  
SHEQISHTHE

EMERTIMI I FLETES:

GJURMA E RRUGES  
EKZISTUES NE  
ORTOFOTO

GRUPI I PROJEKTIMIT:

ING. SILVANA MIO

ING. GJEODET. MARSILDA KAMBERAJ

DREKTORIA E PROJEKTEVE DHE  
EMERJENCAVE CIVILE

ING. ERMENTITA MIO

SHKALLA

Fila: NR 1

1:4000

TETOR 2024

